



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 31 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Përgatitja e projektit të detajuar për restaurimin dhe konsolidimin e Manastirit të Shën Marisë në Apolloni, (Faza e dytë: Projekt zbatimi)”. Gjatë fazës së zbatimit të projektit, të gjitha ndërhyrjet në portik duhet të monitorohen nga specialistë të Parkut Arkeologjik të Apolonisë dhe nga specialistë të Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik”. Ekspozimi në depo i rrënojave arkeologjike, të realizohet me variantin e ballkonit si dhe heqja e strukturave të drurit tip mbulesë të zonave të relaxit.
2. Miratimin e “Projekt-ide, për restaurimin dhe muzealizimin e godinës së Fototekës Kombëtare Marubi (Faza e parë: projekt-ide), Shkodër. Çatia e godinës ekzistuese, të realizohet me beton, por e veshur me konstruksion druri duke ruajtur konfiguracionin e çatisë ekzistuese.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**